



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar / Received / Delivered	30.04	2021	1 viti / god year
Organ / Shërbimi / Organi / Shërbimi / Org / Unit	Nr. Prot. Nr. Prot. Prot. No.	Shtojca / Prilog. Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPM/SHCK	2163/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.281/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.281/2021 të datës 16.04.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit me Nr. Ref:81/2021 të datës 07.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 30.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundim Procedimi administrativ i iniciuar me ankesën me numër A.nr.281/2021 e datës 16.04.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 16.04.2021 ka parashtruar ankesë me Nr.Prot: 1817/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me Nr. Ref:81/2020 të datës 07.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me të cilin është caktuar zëvendësueses në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Ceremonialit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:1817/2021 të datës 16.04.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr. Ref:81/2021 të datës 07.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së; Vendimin A.nr.91/2021 të datës 29.03.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për zbatimin e



vendimi nga Zyra e Sekretarit në MPJD e datës 28.04.2021; Vendimin me Nr. Ref:93/2021 të datës 26.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Politika Konsullore; Vendimin Nr. 8/2021 i datës 21.04.2021 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin lidhur me moszbatimin e vendimit të Këshillit i datës 21.04.2021; Vendimin me Nr.9/2021 të datës 28.04.2021 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me Nr. Prot:722/2021 të datës 19.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit Nr. 063 i datës 23.06.2015; Vendimin me Nr. 117/2020 i datës 01.09.2020; Vendimin me Nr. Ref:254/2020 i datës 31.12.2020; Vendimin me Nr. Ref:774/2018 i datës 10.09.2018; Vendimin me Nr. 301/2020 i datës 10.07.2020; E-mailin e datës 12.02.2021; Vendimin me Nr.Ref:024/2016 i datës 29.01.2016; Vendimin me Numër ZSP/070/14 i datës 28.04.2014; Vendimin me numër ZSP/101/2015 i datës 06.07.2015; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm i datës 12.06.2015; Vendimin me Nr. Ref:255/2020 i datës 31.12.2020 dhe Përgjigjen në ankesë e datës 26.02.2021; Kërkesën e datës 28.04.2021 për tërheqje të ankesës së datës 16.04.2021 nga ankuesi për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit , *sepse:*

Ankuesi fillimisht më datë 19.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet Vendimit me Nr. Ref:254/2020 të datës 31.12.2020 për sistemimin në pozitën Zyrtar i Lartë i Ceremonialit është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse me akt emërim kam mbajtur pozitën Udhëheqës i Divizionit të Ceremonialit në Protokollin e Shtetit dhe është degraduese.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2021 ka nxjerr Vendim A.nr.91/2021 me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me Nr. Ref:254/2020 të datës 31.12.2020, duke e obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të bëjë rishqyrtimin e rastit të ankuesit.

Zyra e Personelit e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 14.04.2021 respektivisht 19.04.2021 ka njoftuar që është zbatuar vendimi i Këshillit për rastin e ankuesit duke bashkangjitur Vendimit me Nr. Ref:81/2021 të datës 07.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo pas shqyrtimit të tij kemi konstatuar që nuk është bërë zbatim i vendimit të Këshillit dhe kemi marr veprimet ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me moszbatimin e vendimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 16.04.2021 kundër Vendimit me Nr. Ref:81/2021 të datës 07.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës pretendon që vendimi i Këshillit nuk është zbatuar.



Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 28.04.2021 ka njoftuar që ka zbatuar vendimin e Këshillit për rastin e ankuesit duke bashkangjitur Vendimin me Nr. Ref:93/2021 të datës 26.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së për sistemimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Politika Konsullore.

Ankuesi më datë 28.04.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës me Nr. Prot: 1817/2021 të datës 16.04.2021 me arsyetimin se: *"...jam i kënaqur me vendimin e fundit nga z.v. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në rrethanat e lartcekura, konstaton se meqenëse ankuesi me kërkesën e datës 28.04.2021 ka tërhequr ankesën e datës 16.04.2021, atëherë bazuar në dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.281/2021

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së;

